



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 23.01.2020

RAPORT

**PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SH.T.Z.ILIR META,
ME NR.11413, DATË 11.01.2020, “PËR KTHIMIN E LIGJIT NR.91/2019, “PËR DISA
NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.97/2013 “PËR MEDIAT AUDIOVIZIVE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”**

Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik mbështetur në nenet 81 dhe 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve 18, 29, 34, 36, 38 dhe 70 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 23. 01. 2020, mori në shqyrtim Dekretin e Presidentit të Republikës, Z. Ilir Meta, me nr.11413, datë 11.01.2020, “Për kthimin e ligjit nr. 91/2019, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013”Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Komisioni caktoi relatorë deputetin z.Musa Ulqini nga mazhoranca dhe znj. Fatjona Dhimitri nga opozita.

Gjatë diskutimit të Dekretit ishin të pranishëm: znj. Etilda Gjonaj, Ministre e Drejtësisë; z.Bledar Dervishaj, këshilltar ligjor në Presidencë; znj. Katrin Treska, drejtore e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike në Presidencë; znj. Sara Xhumbari, drejtore Juridike e AMA- s, si dhe përfaqësuesja e OSBE-së, znj. Ermira Zhari.

LBAZA KUSHTETUESE E DEKRETIT

Dekreti i paraqitur për shqyrtim mbështetet në nenin 85, pika 1, dhe nenin 93 të Kushtetutës.

II. DISKUTIMI NË KOMISION

Fillimisht, në Komision në mënyrë të përmbledhur, duke mbrojtur Dekretin e Presidentit, u shprehën z.Bledar Dervishaj, këshilltar ligjor në Presidencë dhe znj. Katrin Treska, drejtore e Përgjithshme e Shërbimeve Juridike në Presidencë, të cilët, në mes të tjerash, theksuan:

Presidenti i Republikës shqyrtoi ligjin nr. 91/2019, duke iu referuar përmbajtjes së aktit të miratuar dhe praktikës parlamentare të ndjekur për këtë qëllim, duke vlerësuar përputhshmërinë e këtij ligji me Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, parimet e parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, legjislacionit aktual në fuqi, si dhe mbrojtjes së interesit publik.

Në përfundim të shqyrtimit të ligjit nr. 91/2019, Presidenti i Republikës, vlerëson se një pjesë e dispozitave të këtij ligji, nëpërmjet të cilave synohet krijimi i bazës së plotë ligjore për të përmirësuar mbikëqyrjen objektive të shërbimit të medias audiovizive dhe formalizimi nëpërmjet rregjistrimit të ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike *on line* (OSHPE), në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë një hap me tendencë pozitive.

Presidenti i Republikës vlerëson në përgjithësi ndryshimet që ligji nr. 91/2019, sjell mbi identifikimin e ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike, si mjete komunikimi të përhapura gjerësisht në ditët e sotme; vlerëson ndryshimet që sjell ligji nr. 91/2019 sa i përket mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve nga efektet negative që mund të përcillen nga transmetimet në mediat elektronike.

Nga ana tjetër, nga studimi i thelluar dhe krahasues i ligjit të miratuar në tërësi, konstatohet se disa dispozita të tij dhe konkretisht nenet 14, 15, 29, 30, jo vetëm që nuk janë në harmoni, por bien në kundërshtim me: parimet themelore kushtetuese të ndërtimit të një shteti demokratik, sigurisë juridike dhe të proporcionalitetit; Dispozitat kushtetuese që mbrojnë të drejtën e lirisë së shprehjes, të lirisë së shtypit dhe të drejtës së informimit; nuk janë në harmoni me standartet e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut etj.. Parashikimet e nenit 14, pika, 1 germa "c", dhe të nenit 15 të ligjit nr. 91/2019 dhe aplikimi i tyre në praktikë, cenojnë lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, të drejta këto të mbrojtura dhe të garantuara nga neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenet 5, 11/3, 17, 22, 23 të saj etj..

Në diskutimin e saj, znj. Etilda Gjonaj, Ministre e Drejtësisë, duke kundërshtuar Dekretin e Presidentit, ritheksoi argumentat lidhur me domosdoshmërinë e ligjit nr.91/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013”Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë “, të ndryshuar”.

Znj. Gjonaj theksoi se kemi paraqitur në këtë Komision nevojën, qëllimin dhe pasojat, që në fakt një pjesë e tregut të parregulluar ka sjell deri tani, duke shkelur një sërë të drejtash edhe të njerëzve, ndaj duhet t'i shikojmë të drejtat e njeriut në mënyrë komplekse.

Ne e kemi bërë mjaft të qartë se pse ka qenë e nevojshme miratimi i këtyre ndryshimeve, që ka të bëjë me pjesën e paketës antishpifje; e kemi qartësuar edhe se cili ka qenë qëllimi, por pa dyshim edhe nga nevoja për shkak edhe të zhvillimeve teknologjike

Ajo që ka patur si qëllim të gjitha ndryshimet e paketës antishpifje, kanë qenë për të vendosur disa rregulla të qarta, substanciale dhe procedurale për ofruesit e shërbimeve të publikimeve elektronike, për të parandaluar cenimin e dinjitetit dhe reputacionit të individëve, parandalimin e ekspozimit të të miturve nga përmbajtjet e dëmshme, si dhe parandalimin e ekspozimit të gjithë qytetarëve nga gjuha e urrejtjes apo dhunës, por njëkohësisht rregulla të qarta procedurale për sigurimin e një mbrojtje efektive të të drejtave të personave fizikë dhe juridikë, publikë dhe privat, dhe nëpërmjet një mjeti procedural administrativ të shpejt dhe efikas, i cili pa

dyshim synon ndalimin e përhapjes së informacionit të rremë, të pasaktë, tendencioz, ashtu edhe marrjen e masave të shpejta në favor të mbrotjes së të drejtave të njeriut. Por njëkohësisht edhe një sërë qëllimesh të tjera, që kjo paketë ka pasur edhe për t'u përafuar me legjislacionin dhe me standarte ndërkombëtare. E kemi paraqitur qartë këtu se një sërë vendesh demokratike, një sërë vendesh europiane kanë miratuar paketa shumë herë më strikte për sa i përket paketës antishpifje, si Gjermania, Franca, Kroacia.

Znj. Ministre u ndal edhe në punën e bërë ngushtësisht me OSBE-në dhe Këshillin e Europës për këtë ligj, i cili ka si synim mbrotjen e fjalës së lirë dhe integritetit njerëzor etj..

Relatori, deputeti, Musa Ulqini, në diskutimin e tij në mënyrë lakonike u shpreh për procesin e hartimit, diskutimit dhe miratimit të këtij ligji.

Deputeti nënvizoi se mazhoranca ka shprehur të gjithë argumentat për projektligjin në Komision dhe në seancë. Projektligji është diskutuar për një vit dhe është konsultuar me të gjithë aktorët e interesit. Gjatë këtij diskutimi dhe konsultimi atij i janë bërë përmirësime të ndjeshme. Ligji i miratuar respekton Kushtetutën e Republikës dhe standartet demokratike të sanksionuara në dokumentat e BE-së, Këshillit të Europës, etj..

Në Dekret ligjit i njihen vetëm dy arritje pozitive: parandalimi i punës në të zezë të gazetarëve dhe mbrotja e të drejtës të fëmijëve. Ndërkohë, Dekreti anashkalon disa arritje thelbësore të këtij ligji: sanksionimin e transparencës në financimin e portaleve; shmangien e monopolit në sektorin e portaleve, si garanci për pluralizmin e mediave; mbrotjen e privatësisë së qytetarëve; shmangien e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit; mbrotjen e të drejtës së autorit; ndalimin e të gjithë formave të komunikimeve me natyrë tregtare në transmetimet audiovizive dhe publikimet elektronike për lojërat e fatit, bastet sportive, kazinotë dhe bingo televizive; ligji vendos barazi në media, sepse i detyron portalet anonime që publikojnë reklama të respektojnë detyrimet e tyre ndaj arkës së shtetit; garanton të drejtën e qytetarëve për përgenjshtrim kur cenohet pa të dretjë dinjteti i tyre; shmang problemin e madh që një lajm i publikuar nga një portal të publikohet menjherë, copy 5, nga qindra portale të tjera pa asnjë lloj verifikimi.

Ligji ka në thelbin e vet vlerë edukative dhe synon të parandalojë shkeljen e standarteve demokratike nga portalet në mënyrën se si informojnë publikun. Kjo është arsyeja që ligji është kundërshtuar vetëm nga një pjesë e vogël e komunitetit të portaleve dhe jo nga komuniteti i punonjësve të medias së shkruar apo medias radiotelevizive.

Një pjesë e komenteve në Dekretin e Presidentit, siç janë ato për AMA-n, përbërjen e parlamentit, pas largimit të opozitës, raportin e qeverisë me median, etj., janë qëndrime të mirëfillta politike, por jo argumenta juridik, që kanë të bëjnë me ligjin.

Relatorja, Kryetare e Komisionit, Fatjona Dhimitri, duke mbrojtur Dekretin e Presidentit të Republikës vuri në dukje se:

Që në momentin e parë që paketa antishpifje ka mbërritur në Komision, kam qenë kundër saj. Të njëjtin qëndrim kam dhe sot, duke mbështetur Dekretin e Presidentit të Republikës dhe rekomandimet që ai jep për përmirësimin e cilësisë së ligjit.

Në mënyrë të pa precedent në Europë projektligji vendos një regjim kontrolli administrativ mbi internetin, me fuqi për të kontrolluar përmbajtjen, gjobitur dhe etiketuar këto faqe si shpifëse, bazuar në një vendim të thjeshtë administrativ nga një organ që teorikisht është i pavarur dhe praktikisht është i varur nga struktura e pushtetit parlamentar.

Projektligji synon në mënyrë të pavërtetë të fshihet pas argumentit të: a) mbrotjes së fëmijëve ; b) mbrotjes nga terrorizmi apo c) lufta kundër pedofilisë, kur në fakt synimi kryesor në frymë dhe në përmbajtje është informacioni i publikuar në mediat online.

Projektligji më shumë se sa të mbyllë median *online*, duket se synon të krijojë një klimë tensioni të paqenë, duke i dhënë mundësi qeverisë të etiketojë sipas dëshirës kritikët e vet si shpifës, si dhe të përçojë propogandën e vet në çdo faqe interneti përmes teknikës së quajtur *pop up*, përmes së cilës, supozohet se AKEP-i do të urdhërojë shpërndarësit e internetit që sa here një qytetar të aksesojë një faqe interneti kritike, atij t`i hapet automatikisht një dritare që thotë se kjo faqe ka shpifur.

Projektligji i hap rrugë falimentit paraprak të medias *online*, për shkak se gjobat e vendosura nga një organ administrativ, si Këshilli i Ankesave, konsiderohen titull ekzekutiv. Të tilla gjoba mjaftojnë për të shtyrë median drejt vetëcensurës, duke krijuar një klimë të favorshme për lirinë e shpifjes.

Projektligjet i japin AMA-s kompetenca të tilla, që e shndërrojnë atë pikërisht në një organ të censurës mbi mediat onlaine. AMA me kompetenca të zgjeruara përveçse në fushën e mediave audiovizive, edhe në fushën e mediave elektronike fiton kompetenca të tilla, që praktikisht në mënyrë arbitrare mund të mbyllë media apo të vendosë gjoba të tilla që janë të papërbalueshme për mediat.

Projektligjet sjellin pasoja të rënda për lirinë e mediave dhe demokracinë shqiptare.

Në mbledhjen e Komisionit diskutuan për çështje të Dekretit zv/Kryetarja e Komisionit, znj. Mirela Kumbaro, deputetët Ilir Beqja, Erion Piciri, Kostaq Papa dhe Selami Jenishehri.

III. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm, u shpreh kundër Dekretit të Presidentit të Republikës, Z. Ilir Meta, me nr.11413, datë 11.01.2020, “Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend, të ligjit nr.91/2019,“ “ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2013 ”Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar”, dhe i paraqet seancës plenare miratimin e këtij raporti.

R E L A T O R Ë

Musa ULQINI

Fatjona DHIMITRI

K R Y E T A R E

Fatjona DHIMITRI